



## AKTVERIFIKIMI

Në zbatim të nenit 15, shkronjë "j" dhe pika 2 e nenit 30, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", u krye auditimi mbi hartimin e plan veprimit dhe raportimin në KLSH, u auditua zbatimi i rekomandimeve të lëna për përmirësimin e legjislacionit, marrjen e masave organizative, të masave disiplinore dhe të zhdëmtimit, të rekomanduara në përfundimet e auditimit nga KLSH për misionin e mëparshëm të realizuar në këtë subjekt, ku rezultoi se;

Performanca e dobët e raporteve teknike dëme/prime, mungesa e informacionit nga ana e shoqërive të sigurimit mbi raportimet financiare dhe teknike, si dhe çështje të tjera që lidhen me shëndetin financiar të tregut të sigurimeve, natyrshëm të adresojnë te pyetja: *A janë të afta shoqëritë e sigurimeve të përmbushin dhe të paguajnë në kohën e duhur të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kontratat e nënshkruara?* Kjo pyetje nxiti KLSH që gjatë vitit 2015 të auditojë performancën e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, si autoritet publik i pavarur që si objektiva ligjorë ka nxitjen e qëndrueshmërisë, transparencës, besueshmërisë të tregut të sigurimeve; sigurimin e respektimit të ligjit dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Auditimi u krye në përputhje me Standardet e Auditimit të INTOSAI dhe Kodin Etik të KLSH-së, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me efektivitetin e funksioneve rregullative, mbikëqyrëse dhe të zbatueshmërisë në përgjigje të pyetjes kryesore audituese: **"A i ka përmbushur AMF objektivat ligjorë kah garantimit të aftësisë paguese të tregut të sigurimeve?"**

Grupi si burim për vlerësimin e treguesve të aftësisë paguese përdori:

- Raportet vjetore të audituara 2013 dhe 2014 të shoqërive të depozituara në AMF
- Raportimet vjetore të shoqërive në AMF in-Rreg
- Analizat financiare të Departamentit të Mbikëqyrjes 31.12.2013, 31.12.2014 dhe 31.03.2015<sup>1</sup>

Në përfundim dhe respektim të të gjitha fazave të auditimit, KLSH përgatiti në dhjetor 2015 Raportin e Auditimit të Performancës, ku u lanë dhe 14 rekomandime që synonin përmirësimin e punës së AMF-së në përmbushjen e objektivave të saj ligjorë.

• **Për një kuadër rregullativ më të plotë dhe efektiv, KLSH ka lënë 3 rekomandime që konsistojnë në një amendim të bazës ligjore që rregullon kriteret minimale të fondit të garancisë në përputhje me direktivat e BE-së si dhe miratimin e rishikimit të rregullores në zbatim të 9 neneve të Ligjit 52/2014 në përputhje me standardet më të mira të fushës.**

AMF në shkresën e dërguar në KLSH me nr.706/6 prot., datë 08.07.2016, informon se rekomandimi 1 dhe 3 janë të paaplikueshëm, ndërsa për miratimin e rregullores në zbatim të nenit 98/4 (rekomandimi 2 pika e) ka kërkuar shtyrje të afatit deri më 31.03.2017.

KLSH gjatë fazës së ndjekjes së zbatueshmërisë së rekomandimeve, ka marrë informacionin e mjaftueshëm që konfirmon zbatimin e rekomandimit 2 në miratimin e 7 rregulloreve në plotësim dhe zbatim të neneve të cituara në raportin përfundimtar.

<sup>1</sup> Për këto periudha kishte përfunduar procesi i analizës, verifikimit dhe prezantimit në Bord të treguesve të aftësisë paguese.

Në lidhje me moszbatueshmërinë e rekomandimeve 1, 2/h dhe 3, KLSH ka përgatitur informacione të detajuara. (Anekset 1 dhe 2 bashkëngjitur)

- **Për rritjen e efektivitetit të funksionit mbikëqyrës të Autoritetit, janë lënë 6 rekomandime.**

Referuar shkresës nr.706/6 prot., datë 08.07.2016, Autoriteti informon për masat e marra në përmbushje të këtyre rekomandimeve (5-7 dhe 9-11), ndërsa në lidhje me rekomandimin 7<sup>2</sup> komenton se...*me zhvillimin e kuadrit ligjor të tregut të sigurimeve, Autoriteti në bashkëpunim me ekspertë të Bankës Botërore në kuadrin e projektit "Shqipëria: Reforma e tregut të sigurimeve", i cili është zgjatur deri më 31 Mars 2017, po punojnë për hartimin e një rregulloreje të veçantë në lidhje me Rezervën e Katastrofës.*

KLSH mbi bazën e informacionit të marrë nga AMF konsideron masat e deritanishme, por duke qenë se këto rekomandime kërkojnë vëmendjen e institucionit në vijimësi dhe për shkak të natyrës së tyre, vlerësimi ynë për zbatimin e tyre në përgjithësi mbetet subjektive.

- **Në lidhje me masat mbikëqyrëse dhe administrative që merr dhe zbaton AMF për garantimin e një tregu sigurimesh solvent, KLSH i ka kërkuar Autoritetit zbatimin në vijimësi të 3 rekomandimeve (9, 12 dhe 13).**

Në zbatim të këtyre rekomandimeve, AMF në shkresën nr.706/6 prot., datë 08.07.2016, informon që gjatë vitit 2015, pas shqyrtimit të gjendjes financiare të vitit 2014 dhe 3-mujorit të parë të vitit 2015<sup>3</sup> janë marrë 4 vendime Bordi, përkatësisht 2 vendime për marrje masash korigjuese, 1 vendim për plan biznesi dhe urdhër për rritje kapitali dhe 1 vendim për plan rimëkëmbjeje financiare. Gjithashtu po në këtë shkresë, AMF jep informacion të përgjithshëm mbi numrin e shoqërive që nuk kanë aftësi paguese në nivelin e kërkuar për periudhat pas auditimit tonë. Sipas AMF... *për periudhën 30.06.2015 deri më 30.09.2015, vetëm 3 shoqëri sigurimi kanë qenë me tregues të aftësisë paguese nën nivelin e kërkuar, për të cilët janë dërguar shkresa për marrje masash për përmirësimin e treguesve. Masat e Autoritetit që lidhen me treguesit e aftësisë paguese do të reflektohen në analizën e gjendjes financiare të shoqërive për periudhat e raportimit në vijim.*

Në lidhje me masat mbikëqyrëse të marra ndaj shoqërive të sigurimit në vijim në funksion të garantimit të aftësisë paguese dhe treguesve të tjerë të performancës, KLSH kërkoi dhe mori informacion shtesë nga AMF. Sipas këtij informacioni, edhe gjatë vitit 2016 AMF vazhdon të marrë masa të mbikëqyrjes dhe sanksione me gjorbë ndaj shoqërive të sigurimeve për aktivitetin e tyre financiar deri në 3/mujorin e parë 2016.

Grupi konsideron masat e marra nga AMF në përmirësim të shëndetit financiar të shoqërive të sigurimeve dhe në respektimin e ligjit. Por thekson që rekomandimet e lëna nga KLSH në drejtim të një skeme masash mbikëqyrjesh dhe administrative sa më efektive duhet të jetë në vëmendjen e autoritetit në vijimësi, duke qenë se ato merren në reflektim të analizave financiare periodike çdo tremujor. Nisur nga kjo, dhe për faktin që masat e mbikëqyrjes kanë afate zbatimi të përcaktuar në vendimet e Bordit dhe i japin efektet në periudhat në vijim, KLSH në këtë fazë të ndjekjes së rekomandimeve nuk mund të japë një vlerësim objektiv mbi efektshmërinë e funksionit të zbatueshmërisë, por konfirmon masat e nxjerra dhe në ndjekje nga Autoriteti pas përfundimit të auditimit.

<sup>2</sup> Rekomandimi 7: *Autoriteti duhet të kërkojë nga shoqëritë e sigurimit jo vetë që, përveç provizioneve të raportuara deri më sot, të llogarisin dhe raportojnë dhe provizionet e tjera që parasëhëhen nën 89 i ligjit 52/2014. Këto provizione dhe metodologjia që shoqëria përdor për llogaritjen e tyre duhet të miratohet nga Autoriteti.*

<sup>3</sup> Periudha e audituar nga grupi i auditimit të performancës

- **Për të garantuar tregje më transparente** si dhe përgjegjshmëri më të lartë nga ana e shoqërive, KLSH ka lënë 2 rekomandime (4 dhe 14).

Në zbatim të tyre AMF në shkresën nr.706/6 prot., datë 08.07.2016 informon për masat e marra në vijim dhe bën komente duke i konsideruar pjesërisht të aplikueshëm

Sipas AMF, përsa i përket publikimit të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe likuiditetit, sipas Rregullores nr. 110 datë 26.10.2015, "Për përmbajtjen e raportit vjetor që publikohet nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit" nuk kërkohet specifikisht nga shoqëritë e sigurimit të publikojnë treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe të likuiditetit, por **deri në 31.12.2016 do të propozohet amendim i kësaj rregulloreje** duke shtuar edhe këto kërkesa.

Në lidhje me publikimin nga Autoriteti të treguesve të aftësisë në nivel shoqërie, AMF komenton se eksperiencia edhe nga autoritetet e tjera homologe është publikimi i këtyre treguesve në nivel tregu. Ndërkohë që për bërjen publike të vendimeve të bordit për masat e marra ndaj shoqërive, AMF ka sjellë në konsideratë praktikën e ndjekur nga BaFin<sup>4</sup> lidhur me interpretimin e direktivës për transparencën...*Edhe pse tendenca e krijuar lidhet gjerësisht me rritjen e transparencës referuar Direktivës së Transparencës<sup>5</sup>, Autoritetet rregullatore duhet të zbatojnë një qasje të balancuar të bazuar në shembujt e vendeve të tjera. Në lidhje me këtë konstatim është konsultuar dhe me autoritetet rregullatore të disa vendeve si dhe në takimet e bëra me autoritetet e Austrisë, Sllovenisë, Maqedonisë, ku është konkluduar se edhe nga Autoritetet rregullatore homologe ndiqet e njëjta praktikë me argumentin e cituar më lart.*

Mbështetur informacioneve dhe masave të marra nga AMF, KLSH bën komente për zbatimin e çdo rekomandim të dhënë në Aneksin 3, bashkëngjitur këtij raporti.

*Aneksi I: Mbi zbatueshmërinë e rekomandimit 1*

***Rekomandimi I: Për një kuadër rregullator sa më efektiv, Autoriteti të kërkojë amendime të bazës ligjore që rregullojnë kriteret minimale të fondit të garancisë në përputhje me direktivat e BE-së***

*Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2016*

**Në shkresën e AMF për zbatimin e rekomandimeve, ky rekomandim konsiderohet i paaplikueshëm** pasi amendimi sipas tyre është përshtatje me SII. Në lidhje me këtë rekomandim, AMF me shkresën nr.524 datë 29.02.2016 i ka kërkuar Bankës Botërore argumentimin për këtë çështje, e cila asiston AMF në hartimin e akteve dhe amendimeve ligjore në tregun e sigurimeve. Në shënimet e BB mbi raportin e KLSH, pika A, opinioni i tyre është që ... *Amendimet konsistojnë kryesisht në përafrimin e kërkesave të aftësisë pagueve dhe nivelit minimal të fondit të garancisë nën regjimin SII...duke vendosur dhe referencën ne Direktivën 2009/138/EC.*

Grupi sqaron se rekomandimi ynë për amendim të bazës ligjore synon rritjen e nivelit minimal të Fondit të Garancisë në nivelet që përcakton Direktiva 73/239/KEE e ndryshuar nga Direktiva 2002/13/KE. Theksojmë që këto direktiva janë të regjimit SI dhe nocioni "fond garancie" gjendet vetëm në këtë regjim dhe jo në direktivën 2009/138/EC.

<sup>4</sup> Autoriteti Federal i Mbikëqyrjes Financiare i Gjermanisë

<sup>5</sup> Directive 2004/109/EC of the European Parliament and of the Council of 15 December 2004 on the harmonization of transparency requirements in relation to information about issuers whose securities are admitted to trading on a regulated market and amending Directive 2001/34/EC.

Rekomandimi I KLSH për amendim të bazës ligjore është në të njëjtën qëndrim që ka mbajtur AMF kur ka kërkuar ndryshimin e ligjit në vitin 2014. Në relacionin e AMF mbi projektligjin “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, për pikën 4.6 Kreu 6 – Administrimi i rrezikut, AMF shprehet se...*Në këtë projektligj kufijtë e fondit të garancisë janë parashikuar sipas klasave përkatëse në përputhje me kërkesat e legjislacionit evropian. Sipas tabelës së përputhshmërisë, (vënë në dispozicion të grupit gjatë fazës së terrenit)... fondi i garancisë nuk mund të jetë më i ulët se 450 milionë lekë.*

Këto fakte grupi i ka vendosur si gjetje 3 (kopjuar nga raporti më poshtë) në raportin përfundimtar.

**Gjetje 3** - Në legjislacionin shqiptar (neni 81), vlera minimale e fondit të garancisë për një shoqëri që ushtron aktivitet të plotë në sigurim jetë, jo-jetë, ose risigurime, është 370 milion Lekë<sup>6</sup>. Në ndryshimet ligjore të kërkuara, Autoriteti kërkoj si vlerë minimale të fondit të garancisë një shumë më ekuivalente me kërkesat evropiane (450 milion lekë). Ky propozim nuk u pranua pasi... *sipas përfaqësuesve të shoqërive të sigurimit, rritja e Fondit të Garancisë sipas ndryshimeve të propozuara në projektligj nuk është në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës, i cili sanksionon parimin e proporcionalitetit*<sup>7</sup>.

Për gjetjen 3) AMF nuk ka observuar dhe nuk dha evidenca të mjaftueshme që mbështesnin qëndrimin e përfaqësuesve të shoqërive të sigurimit<sup>8</sup>. Në këto kushte, KLSH duke vlerësuar që legjislacioni shqiptar vendos kërkesa më të ulta për nivelin minimal të fondit të garancisë<sup>9</sup>, gjë e cila favorizon më shumë sigurvestin sesa konsumatorin shqiptar, mendoi të rekomandonte amendimin e bazës ligjore që *rregullon kriteret minimale të fondit të garancisë në përputhje me direktivat e BE-së* (të cituara më lart, të regjimit SI)

Në lidhje me zbatimin e këtij rekomandimi, Grupi konsideron shënimet dhe rekomandimet e Bankës Botërore në implementimin e Pillar I, specifikisht për Minimum Capital Requirement (MCR). Në interpretimin që bën BB, kërkesat për MCR (370 mijë lekë) janë ato që përcakton ligji aktual (2014) në nenin 81 për fondin e garancisë, i cili është në fokus të rekomandimit tonë. BB rekomandon që për të shmangur risqet e kursit të këmbimit, në rast të amendimit të ligjit, shuma të vendoset në euro.

---

**PILLAR I: The framework set out qualitative and quantitative requirements for calculation of technical provisions and Solvency Capital Requirement (SCR) using either a standard formula given by the regulators or an internal model developed by the (re)insurance company.**

EU requirements	SII Note	Recommendation
-----------------	----------	----------------

---

<sup>6</sup> Propozimi i Autoritetit në projekt-ligj për reflektimin e kursit historik euro-leke në vlerën e fondit të garancisë nuk u aprovua. Në këtë mënyrë, fondi i garancisë për sigurvestin shqiptarë nuk është ekuivalenti i vlerës sipas kërkesave të direktivave, por shumë më i ulët.

<sup>7</sup> Raport për projekt-ligjin “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimi” nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (13.05.2014)

<sup>8</sup> Pse rritja e Fondit të Garancisë sipas ndryshimeve të propozuara në projektligj nuk është në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës, i cili sanksionon parimin e proporcionalitetit? Cila është metodologjia e përdorur që vlerëson nivelin minimal të FG në 370 mio lekë, duke kënaqur këtë parim?

<sup>9</sup> Rrethimisht dhe për nivelin e kërkuar të aftësisë paguese, duke qënë se niveli i kërkuar i aftësisë paguese e llogaritur deri me sot në shumicën e rasteve rezulton të jetë e barabartë me fondin e garancisë.

In addition to the SCR, a Minimum capital requirement (MCR) must be calculated which represents the threshold below which the national supervisor (regulator) should intervene.

- The current Law determines **Minimum Capital Requirements (MCR) at the level of EUR 2.6 mm (ALL 370 mm)** for insurers which carry out life insurance or non-life insurance (including liability classes of business).
- This amount is **lower than the current MCR amount** defined by the EU (the switch to EU Solvency II approach did not change the EU MCR approach).
- The **MCR amounts are denominated in Albanian currency**, hence their comparison with the EU levels will be subject to changes in exchange rates.
- The current legal approach **does not account for the level of indexation** (as applied in the EU).

A phased approach is recommended for switching to the EU MCR model (subject to market growth), which would mainly affect the small insurers, which have SCR's at levels much lower than the MCR (due to their rather low business volumes).

To this effect, the market development (with the increase of volumes for most of companies in the market) can be associated with the increase of the MCR level.

The decision for the increase of the MCR level should be accompanied with the indexation approach to avoid material changes in the MCR level due to fluctuations in EUR/ALL exchange rate.

In addition, to avoid the exchange rate problem, the change in the Law (when decided), may set the amounts in EUR (*such a currency approach has been already applied in the new Serbian Law (2014), although their amounts are not exactly the same with the EU and not indexed*).

*Përfundim: Nëse ka metodologji, të asistuar dhe nga BB, që e vlerësojnë nivelin minimal të Fondit të Garancisë 2.6 milion euro për rastin e Shqipërisë, atëherë KLSH rekomandon për të ardhmen që nivelet minimale të FG mund të vendosen në monedhën euro (për të shmangur luhatjet e kursit të këmbimit).*

**Aneksi 2: Mbi zbatueshmërinë e rekomandimit 3**

**Rekomandimi 3:** Në lidhje me rregullat që vendosen për investimet e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknik, Autoriteti duhet të bëjë një vlerësim të saktë të objektivave të sigurisë dhe likuiditetit në përcaktimin e limiteve të këtyre investimeve në përputhje dhe me Direktivën 92/49/EEC, si dhe shkallën e zhvillimit të tregut financiar të brendshëm.  
*Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2016*

**Përgjigja e AMF: Rekomandimi konsiderohet i paaplikueshëm, duke sqaruar si më poshtë:**

*Në lidhje me investimet e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, parimet janë në linjë me direktivat (Council Directive 92/49/EEC of 18 June 1992 on the coordination of laws, regulations and administrative provisions relating to direct insurance other than life assurance and amending Directives 73/239/EEC and 88/357/EEC (third non-life insurance Directive)". Pra, përsa i përket kriterit minimal të riskut të kreditit për aktivet në mbulim të provigjoneve, nuk ekziston asnjë standard i tillë i unifikuar, përveç kriterëve që sugjerohen në direktivën e mësipërme. Ligji nr. 52, datë 22.05.2014 në pikën 2 të nenit 97, ndërmjet të tjerash thekson se: "shoqëria e sigurimit në zgjedhjen e llojit të investimeve të aktiveve në mbulim të PT, duhet të garantojë sigurinë, kthimin, likuiditetin dhe tregtueshmërinë e investimeve". Në këto kushte, aktivet e parashikuara nga ligji si jolikuide në llogaritjen e kapitalit, janë konsideruar të papërshtatshme edhe për mbulimin e Provigjoneve Teknike. Gjithashtu Rregullorja nr. 19, datë 28.04.2015 "Për aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe llojet e investimeve të lejuara të këtyre aktiveve" u draftua në përqasje me direktivat e BE-së mbi kufizimet në lidhje me investimin e Aktiveve në Mbulim të Provigjoneve Teknike si edhe me praktikat më të mira marrë nga legjislacione të vendeve si Itali, Kroaci dhe Bullgari lidhur me kufizimet e parashikuara në këtë rregullore.*

Në lidhje me këtë rekomandim, AMF ka observuar që në projekt-raport, duke dhënë argumentet e mësipërm dhe sqarimin se rreziku i investimit nuk bën pjesë tek rreziqet kryesore që hasin siguruesit shqiptarë, për vetë natyrën e kufizuar të instrumenteve financiarë në vend...

Grupi i ka konsultuar me vëmendje komentet e subjektit në fazën e hartimit të raportit, por për rëndësinë që kanë këto rregulla për objektin e auditimit (garantimin e një tregu solvent dhe likuid) **nuk i mori parasysh këto observacione**, duke bërë plotësimet si më poshtë me referencat përkatëse në raportin final, të cilat po i risjellim si argumentet tona në lidhje me papërputhshmëritë me direktivën 92/49/EEC<sup>10</sup>

*Në kontekstin e rregullave të hollësishme që përcaktojnë kushtet për përdorimin e aktiveve të pranueshme, Grupi mendon që AMF (si autoritet rregullues) jep trajtim më pak kufizues se kushtet që vendos Direktiva 92/49/EEC (Artikujt 21-22) për kategoritë e investimeve më pak likuide si p.sh. në kategorinë "Toka dhe Ndërtesa" dhe "Letra me vlerë të listuara si dhe letra me vlerë të tregtuara në një treg të rregulluar dhe pjesëmarrje në fonde investimesh, apo në skemat e investimeve kolektive".*

*Për investimin në kategorinë "Toka dhe Ndërtesa", në Rregulloren nr. 19, datë 28.04.2015, neni 5 pika b) vendoset një kufi maksimal prej 30% të provigjoneve teknike bruto, përfshirë 10 për qind në çdo pjesë toke a ndërtese ose në një numër pjesësh toke apo ndërtesash, afër njëra tjetrës, sa mund të vlerësohen efektivisht një investim. Ndërsa Direktiva 92/49/EEC, Artikulli 22, përcakton që një sigurues nuk mund të investojë më shumë se... pika a) 10 % të provigjoneve teknike totale bruto në një pjesë toke apo ndërtese, ose në një numër pjesësh toke apo ndërtesash, afër njëra tjetrës, sa mund të vlerësohen efektivisht si një investim...*

*Për kategorinë "Letra me vlerë të listuara si dhe letra me vlerë të tregtuara në një treg të rregulluar dhe pjesëmarrje në fonde investimesh, apo në skemat e investimeve kolektive", në Rregulloren nr. 19, datë 28.04.2015, neni 5 pika a) vendoset një kufi maksimal prej 40% të provigjoneve teknike bruto...por një kategori të tillë nuk e shohim të renditur specifikisht në Artikullin 22 të Direktivës 92/49/EEC. Në lidhje me këtë kategori AMF shprehet se është plotësisht e përputhur me pikën b) të këtij Artikulli, pikë të cilën Grupi e gjen përputhshmërisht të përkthyer dhe të vendosur si pika c) në Rregulloren nr. 19, datë*

<sup>10</sup> Në aneksin 1 do të gjeni pjesët e shkëputura nga direktiva BE dhe rregullorja e AMF ku përcakohen limitet e investimeve të aktiveve në mbulim me provigjonet teknike.

28.04.2015 e cila vendos kufirin që një sigurues nuk mund të investojë më shumë se 5 për qind të provigjoneve teknike bruto në aksione dhe letra të tjera me vlerë të listuara në një treg të licencuar letrash me vlerë, si: aksione, obligacione dhe instrumente të tjera të tregut të parasë dhe kapitalit të së njëjtës sipërmarrje apo hua, dhënë të njëjtit huamarrës. Ky kufi mund të rritet në 10 për qind nëse sipërmarrja nuk investon më shumë se 40 për qind të provigjoneve teknike bruto në hua ose letra me vlerë të institucioneve emetuese a huamarrëse, ku në secilën prej tyre ka investuar më shumë se 5 për qind të aktiveve të aktiveve të veta...

Nga ana tjetër, rregullat që përcakton AMF duket se vendosin kushte më kufizuese se kërkesat e Direktivës për aktive likuide; p.sh. sipas pikës h) siguruesi nuk mund të investojë më shumë se 3 për qind të provigjoneve teknike bruto në formën e parasë dhe ekuivalentëve të saj, duke përfshirë në këtë kategori dhe gjendjet në llogaritë bankare dhe depozitat me afat më pak se tre muaj. Ndërkohë që Direktiva 92/49/EEC, Artikulli 22 pika d) këtë kufizim e vendos vetëm për gjendjen e parasë në dorë (cash in hand) dhe jo për gjendjen e parasë në bankë (cash in banks) apo depozitave në bankë, të cilat specifikohen qartazi në Artikullin 21, pika C (m).

Gjithashtu, Grupi vëren se Rregullorja nr. 19, datë 28.04.2015 vendos kritere të ndryshme në vlerësimin e riskut të kreditit; p.sh. Neni 4. Pika 2. kërkon që me miratimin paraprak të Autoritetit...aktivet në mbulim të provigjoneve teknike... mund të investohen edhe në: a) Obligacione afatgjata dhe tituj borxhi afatgjatë të emetuar nga një vend anëtar i BE ose vend anëtar i OECD-së që janë të klasifikuar si **BBB+** e më lart sipas Standart & Poor's ose vlerësimi ekuivalent nga vlerësues të tjerë ndërkombëtarë të njohur gjerësisht, ndërkohë që Neni 5 g) përcakton që 25 për qind e vlerës së provigjoneve teknike në shuma që detyrohen nga ceduesit, risiguruesit, si dhe pjesa e risiguruesit në provigjonet teknike, në përputhje dhe me germën f), pika 1, të nenit 4 të kësaj rregulloreje. Bëjnë përjashtim nga ky kufizim risiguruesit që janë të klasifikuar si **BBB-** e më lart nga Standart & Poor.

Përveç sa më sipër, për zbatueshmërinë e rekomandimit (3) Grupi do të konsiderojë informacionin e dhënë nga AMF në plotësim të rekomandimit (2)<sup>11</sup>, pasi mendon se si rekomandimi 3 ashtu dhe kërkesat e nenit 98<sup>12</sup> synojnë të njëjtin objektiv (vlerësim të saktë të sigurisë dhe likuiditetit të investimit). Grupi vlerëson faktin që BB asiston AMF në hartimin e akteve dhe amendimeve ligjore në tregun e sigurimeve sipas projektit "Shqipëria: Reforma e tregut të sigurimeve". Sipas AMF, në kuadrin e këtij projekti janë draftuar dhe dakordësuar

<sup>11</sup> Rekomandimi 2/5 në raportin e auditimit kërkon që... Për një kuadër rregullator më të plotë dhe më efektiv, Autoriteti të miratojë rregullorët në plotësim dhe zbatim të Nenit 98/4 "Mbi përputhjen e investimeve të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike" të Ligjit 52/2014 dhe në përputhje me standardet me të mira të fushës.

1. Shoqëria e sigurimit përputh në mënyrë të përshtatshme vlerën e investimeve të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike të cilat janë të ekspozuara ndaj rreziqeve të humbjeve të mundshme si rezultat i ndryshimeve në normat e interesit, kurset e këmbimit dhe rreziqeve të tjera të tregut, me përgjegjësitë që rrjedhin nga kontratat e sigurimit në nivelin e cilave varet nga të njëjtat ndryshime.
2. Gjatë investimit të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike, shoqëria e sigurimit merr parasysh afatin për përmbushjen e përgjegjësisë që rrjedhin nga kontratat veçanta të sigurimit.

kërkesat rregullatore në nivel teknik në plotësim të rekomandimit për vendosjen e kërkesave rregullatore në zbatim të Nenit 98/4 "Mbi përputhjen e investimeve të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike", por për shkak të ngarkesës dhe mos arritjes të dorëzimit në kohë të të gjithë draft akteve nga ana e BB është zgjatur deri deri më datën 31 Mars 2017.

II. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna me shkresën nr.1034/7, datë 31.03.2015, të Kryetarit të KLSH-së.

#### **A. MASA ORGANIZATIVE.**

##### ***Rrekomandimi nr. 1:***

Nga institucioni të ndiqet një politikë të kujdesshme dhe e mirëpërcaktuar lidhur me mënyrën e krijimit, nivelin e kontributeve të paguara, të cilat asnjëherë nuk duhet të tejkalojnë masën e kontributeve të detyrueshme të paguara për çdo punonjës si dhe mënyrën e administrimit të këtij fondi duke qenë të kujdesshëm për të eliminuar risqet e konfliktit të interesit.

**Përgjigja e AMF:** Nga Autoriteti me Vendim Bordi nr.77, datë 31.08.2015 "Për miratimin e disa ndryshimeve në Planin e Pensionit Profesional për punonjësit e AMF-së", janë marrë masa për ndjekjen e një politike më të kujdesshme për nivelin e kontributeve të paguara. **Në nenin 11**, "Kontributi mujor i AMF-së është në masën 5% të pagës mujore bruto të çdo punonjësi që merr pjesë në planin profesional të pensionit, por jo më shumë se kontributi që derdh AMF për sigurimin e detyrueshëm", dhe në **nenin 12**, Kontributi mujor i punonjësit është në masën jo më pak se 2(dy) për qind të pagës mujore bruto të tij". Bashkëlidhur Vendimi i Bordi nr.77, datë 31.08.2015.

**Ky rekomandimi konsiderohet i zbatuar.**

##### ***Rekomandimi nr. 2:***

Nga auditimi mbi të ardhurat u konstatua se në periudhën e auditimit gjobat e pambledhura kapin shumën prej 5,500,000 lekë, që përfaqëson vlerën e gjobave të vendosura nga AMF-ja, gjatë periudhës 2006-2012 për 6 shoqëri sigurimi dhe 3 individë. Ndërsa, gjendja e këtyre detyrimeve në fund të periudhës së auditimit 2014 arriti në shumën 1,700,000 lekë. Për arkëtimin e gjobave institucioni vazhdimisht i është drejtuar zyrtarisht shoqërive të sigurimit duke i kërkuar ekzekutimin e detyrimeve që rrjedhin nga sanksionet në fjalë, në një kohë që mund ta zbriste detyrimin për shumën e gjobave të vëna shoqërive të sigurimit, nga shuma e parapagimit të njohur për vitin e ardhshëm. U konstatua se në referencë të ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, percaktohej se 80 % e gjobës derdhej në buxhetin e shtetit, i cili u shfuqizua me ligjin nr.52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit".

##### ***Rekomandimi nr. 3:***

Pasqyrat financiare të entitetit ndonëse janë certifikuar nga një ekspert kontabël i pavarur, i cili ka dhënë një opinion të pakualifikuar, pasi nga auditimi u konstatuan disa pasaktësi në kontabilizimin dhe paraqitjen e të ardhurave të shtyra si dhe mungesë të informacionit shpjegues në lidhje me lëvizjet e aktivet e trupëzuara të cilat ishin në nivel material për vitin 2013. Nga ana tjetër duke qenë se, institucioni zbaton rregullat e një institucioni buxhetor, amortizimi nuk përfshihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve por rregullohet tek vlera e fondeve në dispozicion. Kjo tregon se megjithëse është një entitet i pavarur që mbahet me fondet e veta, kontabiliteti nuk reflekton këtë situatë.

***Për sa më sipër është rekomanduar:***

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Sektori i Administrimit Financiare të marrë masat e duhura për hartimin e pasqyrave financiare bazuar në standardet ndërkombëtare të kontabilitetit duke reflektuar statusin e një autoriteti të pavarur financiar si dhe të synohet



drejt certifikimit të pasqyrave financiare nga ekspertë kontabël me eksperiencë ndërkombëtare dhe të familjarizuar me institucione financiare e sidomos trajtimet kontabël të aktivitetit të tyre.

**Përgjigja e AMF:** Për vitin 2015, Autoriteti ka patur përsëri komunikim shkresor me Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit dhe Ministrinë e Financave për shqyrtimin dhe marrjen sa më të shpejtë të një vendimi për ndryshimin e standardeve kontabël për hartimin e pasqyrave financiare.

Autoriteti është në proces për përshtatjen e standardeve kontabël SNR dhe SNR1. Sipas kontratës me nr. 2144 prot, datë 13.10.2015, të lidhur me subjektin Grant Thornton shpk, auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2015 është kryer nga kjo shoqëri.

**Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.**

***Rekomandimi nr. 4:***

Për periudhën objekt auditimi, njësia ka funksionuar dhe është organizuar mbi bazën e strukturës dhe organikës të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Vendimin nr. 98, datë 30.04.2007 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare". Kjo strukturë nuk përputhet me kërkesat e vendimit të KM nr. 474, datë 16.06.2011 "Për përcaktimin e standardeve të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike", pasi, në strukturën e miratuar ka drejtori, apo sektorë që nuk përputhen me kërkesat e vendimit të mësipërm sipas pikës 20 ku citohet: "Një sektor mund të krijohet si njësi organizative e veçantë kur në të janë të paktën një pozicion shef sektori dhe dy vartës. Një sektor mund të krijohet edhe pa pozicionin e shefit, nëse është në kuadër të një drejtorie dhe ka të paktën dy nëpunës" dhe pikës 21 ku citohet: "Një drejtori mund të krijohet nëse ka në përbërje të saj të paktën dy sektorë të drejtuar nga një shef ose nëse ka të paktën 5 (pesë) punonjës". Kështu, Sektori i Modelimeve Financiare, Sektori i Letrave me Vlerë, Sektori i Monitorimit, Sektori i Çështjeve Ligjore, Sektori i Hartimit të Akteve, Sektori i Mbrojtjes së Investitorëve, kanë në përbërje të tyre vetëm 1 specialist. Gjithashtu, Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit ka 2 sektorë pa shef, gjithsej 4 punonjës, 1 drejtor dhe 3 specialistë, Drejtoria e IT, ka gjithsej 2 punonjës një drejtor dhe 1 specialist, Drejtoria e Rregullimit dhe Standardeve ka gjithsej 3 punonjës, 1 drejtor dhe 2 specialistë, Drejtoria Juridike ka 2 sektorë pa shef, gjithsej 3 punonjës 1 drejtor dhe 2 specialistë, Drejtoria e Zbatueshmërisë ka 2 sektorë pa shef, gjithsej 4 punonjës, 1 drejtor dhe 3 specialistë. Struktura e Auditimit të Brendshëm ka 1 punonjës me emërtimin inspektor, në bazë të ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", i ndryshuar, duhet të emërtohet auditues.

Njësia për ndryshimin e strukturës organike nr. 98, datë 30.04.2007, gjatë viteve 2008-2011, ka dërguar për miratim në Kuvend ndryshimet përkatëse por, deri tani Kuvendi nuk ka miratuar ndryshimin e strukturës pasi, me të drejtë pas marrjes së opinionit nga Departamenti i Administratës Publike, ka bërë vërejtjet e tij. Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues dhe menaxherë të tjerë të njësisë, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre por, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", neni 15 "Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave", njësia nuk ka rregulla të brendshme të miratuara, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre.

***Për sa më sipër është rekomanduar:***

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të marrë masat e duhura, për të bërë ndryshimin e strukturës organike, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe me akte administrative të brendshme, të përcaktojë delegimin e kompetencave apo, të detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre, në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

**Përgjigja e AMF:** Me Vendim Bordi nr. 27, datë 28.04.2015 "Mbi strukturën organizative, numrin e punonjësve dhe përshkrimeve të punës në AMF", i ndryshuar me Vendimin nr.78, datë 31.08.2015, është miratuar struktura e re organizative e AMF-së. Rregullorja e brendshme është në proces dhe do të miratohet në mbledhjen e radhës në muajin dhjetor 2015. Bashkëlidhur vendimet e bordit.

**Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.**

***Rekomandimi nr. 5:***

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, të marrë masa të menjëhershme që, në kushtet e një institucioni të pavarur të hartojë rregulla të qarta dhe mënyrën e dokumentimit të shpenzimeve të natyrës së përgjithshme në përputhje me kërkesat e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" duke synuar gjithmonë minimizimin e angazhimeve financiare të panevojshme.

**Përgjigja e AMF:** Me Vendimin e Bordit nr.30, datë 28.08.2015 "Për disa ndryshime në Rregulloren nr. 83, datë 29.06.2011 "Mbi marrëdhëniet financiare të punonjësve me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", u përcaktuan shpenzimet që punonjësit e Autoritetit përfitojnë në kohën e punës. Ky rregullim është në kuadër të trajtimit të punonjësve dhe krijimin e kushteve më të mira gjatë ushtrimit të detyrës. Vlerësojmë se shpenzimet e natyrës së përgjithshme janë të justifikuara, efektive dhe që synojnë rritjen e rendimentit të punës, me qëllim krijimin dhe sigurimin e kushteve optimale të punës. Bashkëlidhur fotokopje e Vendimit të Bordit.

**Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.**

***Rekomandimi nr. 6:***

Në bazë të ligjit dhe manualit për auditimin e brendshëm në sektorin publik, për vitet 2013-2014, struktura e Auditimit të Brendshëm ka hartuar planet vjetore të auditimit dhe mbi bazën e tyre ka realizuar auditimet. Për kryerjen e auditimeve në zbatim të manualit të auditimit, janë hartuar programet e auditimit për çdo subjekt të audituar. U konstatua se kjo strukturë në planet e auditimit nuk ka përcaktuar në objektivat e saj, vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm mbi bazën e pesë komponentëve si, mjedisi i kontrollit, menaxhimit i riskut, aktivitetet e kontrollit, informacioni dhe komunikimi dhe monitorimi, kërkesa këto të parashikuara në ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik".

***Për sa më sipër është rekomanduar që:***

Struktura e Auditimit të Brendshëm të marrë masa që, në të ardhmen në programet e auditimit të përcaktojë si drejtim vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm mbi bazën e pesë komponentëve si, mjedisi i kontrollit, menaxhimit i riskut, aktivitetet e kontrollit, informacioni dhe komunikimi dhe monitorimi.

**Përgjigja e AMF:** Në planin vjetor të vitit 2015, miratuar me vendim Bordi nr.113, datë 26.10.2015 "Për miratimin e planit vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2016 dhe planit strategjik për vitet 2016-2020", Auditimi i Brendshëm ka planifikuar kryerjen e angazhimit të auditimit mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Bashkëlidhur fotokopje e Vendimit të Bordit dhe plani vjetor i Auditimit të Brendshëm.

**Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.**

***Rekomandimi nr. 7:***

Në tenderin me objekt "*Blerje karburanti*" rezultoi se, nga Autoriteti Kontraktor, para pagimit të faturës së mallit, nuk është bërë kontrolli i përqindjes së rritjes apo, të uljes së

çmimit të bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, si dhe cilësinë e karburantit, nëse është e njëjtë me atë të deklaruar nga operatori ekonomik në ofertën e tij, parashikuar në VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik, i ndryshuar.

***Për këtë është rekomanduar:***

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, të marrë masat që para pagimit të faturës së mallit për blerjen e karburantit, të bëhet kontrolli i përqindjes së rritjes apo, të uljes së çmimit të bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, si dhe cilësinë e karburantit, nëse është e njëjtë me atë të deklaruar nga operatori ekonomik në ofertën e tij, parashikuar në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik, Kreu VIII “Ekzekutimi i Kontratës”, pika 2, germa c.

**Përgjigja e AMF:** Rekomandimi ka gjetur zbatim menjëherë, në çdo procedurë blerje karburanti, përpara pagimit të faturës, është bërë kontrolli i çmimit të bursës.

**Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.**

***Rekomandimi nr. 8:***

Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, germa a, dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. IV “Zbatimi i MFK”, pika, 4.2.8 “Përgjegjësitë e Titullarëve të Njësive të Sektorit Publik”, njësia për periudhën objekt auditimi, nuk ka hartuar dhe miratuar planin strategjik i cili përmban objektivat strategjik, prioritetit e institucionit dhe planet e veprimit.

***Për sa më sipër është rekomanduar:***

Në funksion të rritjes së cilësisë të menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, të marrë masat e duhura për të hartuar dhe miratuar, planin strategjik duke e azhurnuar atë çdo vit, i cili të përmbajë objektivat strategjike, prioritetit të institucionit dhe planet e veprimit, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

**Përgjigja e AMF:** Plani strategjik i AMF-së është hartuar dhe miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv me nr. 271 prot, datë 15.07.2015.

**Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.**

***Rekomandimi nr. 9:***

Për periudhën objekt auditimi struktura e Auditimit të Brendshëm ka konstatuar gjetje në **shumën 426 mijë lekë**, nga të cilët 421 mijë lekë, janë si rezultat i mosmbajtjes së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga punëdhënësi 252 mijë lekë dhe punëmarrësi 169 mijë lekë, për raportet mjekësore deri në 14 ditë dhe mosmbajtje të tatimit mbi të ardhurat personale në shumën 5 mijë lekë. Ndonëse kjo gjetje konsiderohet e drejtë por nuk është lënë rekomandim për derdhjen e shumës së mësipërme për skemën e sigurimeve shoqërore, por vetëm korrigjimin në të ardhmen.

***Për këtë është rekomanduar që:***

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, të marrë masat e duhura për mbajtjen dhe derdhjen e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, në **shumën 421 mijë lekë**, për raportet mjekësore deri në 14 ditë, dhe **shumën 5 mijë lekë** për tatimit mbi të ardhura.

**Përgjigja e AMF:**

Me implementimin e sistemit të ri informatik të administratës tatimore në muajin janar 2015, nuk mund të kryhen sistemime për periudha të mëparshme. Autoriteti me shkresën nr. 810 prot, datë 20.04.2015, i është drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore, dhe ka kërkuar asistencë për saktësimin e deklaratave tatimore dhe me shkresën nr. 810/3 prot, datë 20.04.2015, në

përgjigje të shkresës së Drejtorisë Rajonale Tatimore, AMF ka dërguar tabelat përkatëse me ndryshimet e rubrikave të kërkuara. Deri më sot nga Drejtoria Rajonale Tatimore nuk është marrë asnjë veprim në lidhje me sistemit përkatëse.

**Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.**

***Rekomandimi nr.10 :***

Në bazë të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu I “Dispozita të Përgjithshme”, neni 4 “Përkufizime”, nëpunësi autorizues është nëpunësi i nivelit më të lartë të menaxhimit në njësinë publike, përgjegjës për zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha strukturat, programet, aktivitetet dhe proceset që menaxhohen prej tyre ndërsa, nëpunësi zbatues është nëpunësi i nivelit të lartë menaxhues të njësisë, i cili është përgjegjës për zbatimin e rregullave që lidhen me menaxhimin financiar, kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të njësisë, si dhe përgjigjet para nëpunësit autorizues të njësisë. Me gjithë kërkesën e grupit të auditimit, nuk na u paraqit asnjë shkresë për caktimin e nëpunësit autorizues dhe zbatues, në kundërshtim me ligjin e mësipërm.

***Për këtë është rekomanduar:***

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të marrë masat e duhura, për të caktuar nëpunësin autorizues që është përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxheteve të tyre, si dhe të caktojë nëpunësin zbatues, koordinatorin e riskut dhe grupin e menaxhimit strategjik (GSM) i cili ka për qëllim të diskutojë çështjet kryesore dhe mangësitë serioze me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave.

**Përgjigja e AMF:** Titullari i Autoritetit me urdhrin nr. 43, datë 17.04.2015, ka caktuar nëpunësin autorizues, kordinatorin e riskut dhe grupin e menaxhimit strategjik (GMS). Ndërsa me urdhrin nr. 44, datë 17.04.2015, është caktuar nëpunësi zbatues i AMF- së. Bashkëlidhur fotokopje të urdhrave përkatëse.

**Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.**

***Rekomandimi nr. 11:***

Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë vitit 2013, njësia ka organizuar trajnime për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve kryesisht në fushën e tregut të sigurimeve, siç është bashkëpunimi me Bankën Botërore për trajnimin “Aspekte Aktuale të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik në Shqipëri”, trajnim i cili mundësoi prezantimin e metodave të reja në llogaritjen e primit të riskut në kontratat e sigurimit të detyrueshëm. Gjithashtu, njësia ka organizuar dhe trajnimin online për programin “FSI Connect”, për thellimin e njohurive të punonjësve në drejtim të mbikëqyrjes në fushën e sigurimeve por, të pamjaftueshme nëse nuk kombinohen me plane të qarta institucionale për trajnimin e vijueshëm të kapaciteteve njerëzore që ka institucioni.

***Për sa më sipër është rekomanduar:***

Për arritjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve, institucioni të hartojë dhe miratojë programe specifike për ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve njerëzore që ka në dispozicion sidomos në fushat specifike të monitorimit të tregut financiar.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Financës, punonjësit të trajnohen dhe në kuptimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe manualit të dalë në zbatim të tij, pasi konstatuam se drejtuesit nuk zotërojnë informacion të mjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollin dhe se ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin, nuk ka funksionuar në të gjitha hallkat e njësisë.

Të punohet për ngritjen e një sistemi informacioni që mbledh dhe dokumenton nevojat e çdo punonjësi për trajnim dhe nivelin e trajnimeve, të realizuara gjatë një viti dhe ta bëjë këtë indikator pjesë të vlerësimit periodik të punës së tyre.

**Përgjigja e AMF:** Autoriteti ka krijuar Qendrën e Edukimit, e cila do të kontribuojë në rritjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve, nëpërmjet programeve specifike. Është hartuar dhe miratuar me nr. 429 prot, datë 30.10.2015, Plani i Zhvillimit të Burimeve Njerëzore në AMF, që do të aplikohet për nevojat për trajnim të punonjësve duke e bërë pjesë të vlerësimit dhe zhvillimit profesional. Zbatimi i këtij procesi që lidhet me zhvillimin profesional të punonjësve do të gjejë zbatim për vitin 2016.

Bashkëlidhur fotokopje e praktikës së Planit të Zhvillimit të Burimeve Njerëzore në AMF.

**Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.**

**Rekomandimi nr. 12:**

Pas planifikimit të fondeve, institucioni analizon dhe bën kontrollin e risqeve të cilët mund të venë në rrezik realizimin e treguesve financiarë por, në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.2 "Menaxhimi i riskut", njësia nuk ka hartuar strategjinë e riskut dhe për pasojë, drejtuesit nuk janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kanë në menaxhimin e riskut.

**Për këtë është rekomanduar:**

Për të rritur përgjegjshmërinë në menaxhimin e riskut, në drejtim të identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut, institucioni të marrë masat e duhura për të hartuar dhe miratuar strategjinë e riskut, e cila duhet të përditësohet rregullisht, të paktën 1 herë në 3 vjet, si dhe sa herë kur mjedisi pëson ndryshime të rëndësishme, duke bërë kështu vlerësimin dhe kontrollin e risqeve që venë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë.

**Menjëherë.**

**Përgjigja e AMF:** Strategjia e riskut të AMF-së është hartuar dhe miratuar me nr.271 prot, datë 15.07.2015 nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv.

**Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.**

**Rekomandimi nr. 12:**

Në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", neni 16, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, "Gjurmët e auditimit", njësia nuk ka hartuar gjurmët e auditimit që ka si qëllim, të ndihmojë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet, etj.

**Për këtë është rekomanduar:**

Me qëllim që të ndihmohet menaxhimi për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të merren masat për të hartuar gjurmët e auditimit, ku të përfshihen proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve me të rëndësishme.

**Përgjigja e AMF:** Gjurmët e auditimit të AMF-së janë hartuar dhe miratuar me nr. 449 prot, datë 17.11.2015 nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv.

**Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.**

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.**

Nga auditimi rezultoi se, institucioni për periudhën objekt auditimi, ka kryer *shpenzime për trajnime* për punonjësit e tij, kështu në bazë të Vendimit të Bordit nr. 178, datë 13.12.2011,

janë kryer shpenzime të pambështetura në dispozita ligjore, për mbështetjen financiare të punonjësës *znj. Jona Mele*, për kryerjen e studimeve pasuniversitare (2 vjet) në Universitetin "New York Tirana", në masën 90% të tarifës së shkollimit, në shumën 2,950 euro, gjithsej për të dy vitet 2012-2013, janë paguar **5,850 Euro**.

**Për sa më sipër është rekomanduar:**

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, të ndjekë procedurat ligjore për të kërkuar shpërblimin për shumën **5,850 Euro**, nga *znj. Jona Mele*, për sa paguar për kryerjen e studimeve pasuniversitare (2 vjet) në Universitetin "New York Tirana", në masën 90% të tarifës së shkollimit, shpenzime të cilat janë kryer jo në mbështetje të dispozitave ligjore.

**Menjëherë**

**Përgjigja e AMF:** Sqarojmë se shpenzimi i kryer është në mbështetje të dispozitave ligjore. Vendimi i Bordit nr.178, datë 13.12.2011, është në zbatim të nenit 14, pika 23 të ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare". Ky Vendim është bazuar në nenin 18 të Rregullores nr. 83, datë 29.06.2011 "Mbi marrëdhëniet financiare të punonjësve me AMF", të miratuar nga Bordi i AMF-së, në të cilin citohet "Bordi me propozim të Kryetarit përcakton fushat e kualifikimit për kurset/studimet apo trajnimet që do të financohen nga Autoriteti", si dhe Rregullores nr.7, datë 30.08.2007 "Për rregullat e brendshme të AMF-së". Mbështetja financiare për kualifikimin profesional të punonjësve që lidhen me fushën ku ata punojnë bazohet në politikën e burimeve njerëzore në AMF, dhe është në përputhje me të gjitha kriteret e përcaktuara për akordim të mbështetjes financiare. Gjithashtu theksojmë se Vendimet e Bordit janë vendime kolegjiale dhe votimi për këtë rast ka qenë unanim. Financimi i kryer për studimet pasuniversitare për *znj. Jona Mele*, nuk është rast i përsëritur dhe është trajtuar në një periudhë të kaluar.

**Ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.**

Ky akt-verifikim mbahet në 3 (tre) kopje, nga të cilat 1 (një) kopje i lihet institucionit, dhe dy kopje merren nga audituesit e KLSH-së.

Në bazë të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 15, pika "dh", duhet të na ktheni 1 (një) kopje të nënshkruar, së bashku me vërejtjet përkatëse nëse do të keni brenda 1 (një) jave nga data e marrjes së këtij aktverifikimi.

Për AMF

Enkelelda SHEHI



Grupi i Auditimit

Andrea KRISTO

Enkelejda TOLE

Pjetër BELESHI

Aneksi 3: Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të performancës në AMF

Nr.	Rekomandimi KLSH	Afati i zbatimit	Shkalla e zbatimit sipas AMF	Komenti i AMF	Opinionit KLSH
1	<p><i>Për një kuadër rregullator sa më efektiv, Autoriteti të kërkojë amendime të bazës ligjore që rregullojnë kriteret minimale të fondit të garancisë në përputhje me direktivat e BE-së</i></p>	<p><i>Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2016</i></p>	<p>Konsiderohet i paaplikueshëm</p>	<p>Lidhur me këtë rekomandim është kërkuar dhe opinionit i Bankës Botërore, sipas shkresës së Autoritetit me nr. 524, prot, datë 28.02.2016, e cila në kuadër të projektit “<i>Shqipëria: Reforma e tregut të sigurimeve</i>” asiston AMF në hartimin e akteve dhe amendimeve ligjore në tregun e sigurimeve. Në opinionin e dhënë me datë 31.05.2016, Banka Botërore, ndër të tjera, shprehët që vendimi për të kryer amendime të bazës ligjore, për përshatjen e saj me Solvency II (përsa i përket kriterëve minimale të fondit të garancisë), duhet të jetë subjekt i zhvillimit te tregut të sigurimeve në Shqipëri.</p>	<p>Grupi sqaron se rekomandimi ynë për amendim të bazës ligjore synon rritjen e nivelit minimal të Fondit të Garancisë në nivelet që përcakton Direktiva 73/239/KEE e ndryshuar nga Direktiva 2002/13/KE. Theksojmë që këto direktiva janë të regjimit SI dhe nocioni “fond garancie” gjendet vetëm në këtë regjim dhe jo në direktivën 2009/138/EC. (Për më tepër, kemi përgatitur informacion të vecantë, dërguar me e-mail)Nëse ka metodologji, të asistuar dhe nga BB, që e vlerësojnë nivelin minimal të Fondit të Garancisë 2.6 milion euro për rastin e Shqipërisë, atëherë KLSH rekomandon për të ardhmen që nivelet minimale të FG të shprehen në monedhën euro (për të shmangur luhatjet e kursit të këmbimit).</p>

<p>2</p> <p><i>Per një kuadër rregullator më të plotë dhe më efektiv, Autoriteti miratojë rregulloret në plotësim dhe zbatim të neneve të Ligjit 52/2014 dhe në përputhje me standardet me të mira të fushës.</i></p>	<p><i>Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2016</i></p>	<p>Rekomandimi është zbatuar</p>	<p>Autoriteti për periudhën janar-qershor 2016, ka miratuar rregulloret e mëposhtme në zbatim të ligjit 52/2014.</p>	<p>Grupit i janë vënë në dispozicion rregulloret e hartuara në zbatim të neneve përkatëse sic janë rekomanduar nga auditimi i performancës. Këto rregullore gjenden dhe në faqen zyrtare të AMF, të cilat i kemi vendosur me link si më poshtë</p>
<p>a</p> <p><i>Neni "Investimet" 78/5</i></p>			<p>- Rregullore nr. 76, datë 30.05.2016 "Mbi kategoritë e investimeve të lejuara, kufizimet që zbatohen dhe përdorimin e instrumenteve financiare derivative", në zbatim të nenit 78, pikat 5 dhe 6 dhe nenit 99 pika 3, të ligjit 52/2014.</p>	<p><a href="http://amf.gov.al/pdf/ligje/10242_Rregullore%20nr.%2076%2030052016.pdf">http://amf.gov.al/pdf/ligje/10242_Rregullore%20nr.%2076%2030052016.pdf</a></p>
<p>b</p> <p><i>Neni 79 "Elementet e zbritshëm për llogaritjen e kapitalit"</i></p>			<p>- Rregullore nr. 87 datë 27.06.2016 "Për elementët e zbritshëm në llogaritjen e kapitalit dhe klasat e aktiveve ku zbatohen ato" në zbatim të nenit 79 pika 3, të ligjit 52/2014.</p>	<p><a href="http://amf.gov.al/pdf/publikime/1573_Nr.%2087,%20dat%C3%AAB%2027.06.2016.pdf">http://amf.gov.al/pdf/publikime/1573_Nr.%2087,%20dat%C3%AAB%2027.06.2016.pdf</a></p>



c	<p><i>Neni "Administrimi i likuiditetit"</i> 84/4</p>	<p>- Rregullorja nr. 56, datë 28.04.2016 "Mbi administrimin e likuiditetit nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit", në zbatim të nenit 84/4 të ligjit 52/2014.</p>	<p><a href="http://amf.gov.al/pdf/publikime/1542_Nr.%2056,%20dat%C3%AB%2028.04.2016.pdf">http://amf.gov.al/pdf/publikime/1542_Nr.%2056,%20dat%C3%AB%2028.04.2016.pdf</a></p>
d		<p>- Rregullorja nr. 8, datë 25.01.2016 "Mbi bazat dhe metodat e llogaritjes, mënyrat e mbajtjes së provigjoneve matematike, si dhe kriteret dhe procedurat e miratimit të tyre nga Autoriteti", si dhe rregullorja nr. 9, datë 25.01.2016 "Mbi bazat dhe metodat e llogaritjes, mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike, si dhe kriteret dhe procedurat e miratimit të tyre nga Autoriteti" në zbatim të nenit 89 të ligjit 52/2014.</p>	<p><a href="http://amf.gov.al/pdf/publikime/1486_Nr.%208,%20dat%C3%AB%2025.01.2016.pdf">http://amf.gov.al/pdf/publikime/1486_Nr.%208,%20dat%C3%AB%2025.01.2016.pdf</a>  <a href="http://amf.gov.al/pdf/publikime/1487_Nr.%209,%20dat%C3%AB%2025.01.2016.pdf">http://amf.gov.al/pdf/publikime/1487_Nr.%209,%20dat%C3%AB%2025.01.2016.pdf</a>  Në lidhje me llogaritjen provigjoneve teknike të katastrofës, ne konsiderojmë komentin e AMF të dhënë në paragrafet e zbatimit të rekomandimit 7. Sipas AMF... me zhvillimin e kuadrit ligjor të tregut të sigurimeve, Autoriteti në bashkëpunim me ekspertë të Bankës Botërore në kuadrin e projektit "Shqipëria: Reforma e tregut të sigurimeve", i cili është zgjatur deri më 31 Mars 2017, po punojnë për hartimin e një rregulloreje të vecantë në lidhje me Rezervën e Katastrofës.</p>

	<p>- Në plotësim të rekomandimit për vendosjen e kërkesave rregullatore në zbatim të Nenit 98/4 “Mbi përputhjen e investimeve të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike” janë draftuar dhe dakordësuar kërkesat rregullatore në nivel teknik në kuadër të projektit “Shqipëria: Reforma e tregut të sigurimeve” me Bankën Botërore e cila asiston AMF në hartimin e akteve dhe amendimeve ligjore në tregun e sigurimeve sipas projektit, i cili për shkak të ngarkesës dhe mos arritjes të dorëzimit në kohë të të gjithë draft akteve nga ana e BB është zgjatuar deri deri më 31 Mars 2017. Vendosija e kërkesave rregullatore për këtë nen të ligjit 52/2014 është adresuar në rregulloren e Investimeve në mbulim të provigjoneve matematike. Draft rregullorja është në proces përkthimi.</p>	<p>Grupi ndan të njëjtën opinion me BB kur shënon që...ëhile the current approach provides clear rules for the investment of technical provisions, under the EU Solvency II, insurers are not bound to rules, but should measure the risk of their assets. Në shtesë të këtij shënimi rregullat për llojin dhe kufijtë e investimeve përcaktohen në regjimin SI. (grupi në raport ka dhënë referencat me direktivën përkatëse). Përdërisa nenet 97/5 dhe 98/4 të ligjit aktual të sigurimeve parashikojnë nxjerrjen e rregullave për përputhjen e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, atëhere AMF është e detyruar t'i përmbushë. KLSH konsideron afatin e shtyrë nga BB në komentun që bën AMF për këtë pikë.</p>
c	<p><i>Neni 98/4 e "Përputhja e investimeve"</i></p>	

f	Neni 146/5 "Mjaftueshmëria e kapitalit të një grupi sigurimi"		- Amendim i Rregullores nr. 34, me vendim bordi nr. 77, datë 30.05.2016, për afatet kohore, përmbajtjen e raporteve, mënyrën e raportimit, si edhe metodën e llogaritjes së mjaftueshmërisë së kapitalit të një grupi sigurimi, (neni 146/5, i ligjit 52/2014).	<a href="http://amf.gov.al/pdf/publikime/1563_Nr.%2077,%20dat%C3%AAB%2030.05.2016.pdf">http://amf.gov.al/pdf/publikime/1563_Nr.%2077,%20dat%C3%AAB%2030.05.2016.pdf</a>
g	Neni 118 "Mbulimi i rreziqeve të mëdha"		- Rregullorja nr. 85/1, datë 30.09.2015 "Për kriteret e risigurimit", e ndryshuar me Vendim nr. 88, datë 27.06.2016. Kjo rregullore hartohet në mbështetje të nenit 116, pika 3, nenit 117, pika 7, 118, pika 2 dhe 119, pika 4, të ligjit nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".	<a href="http://amf.gov.al/pdf/publikime/1575_Nr.%2089,%20dat%C3%AAB%2027.06.2016.pdf">http://amf.gov.al/pdf/publikime/1575_Nr.%2089,%20dat%C3%AAB%2027.06.2016.pdf</a>
h	Neni 119 "Bashkësigurimi"		- Përsa i përket rregullave të tjera shtesë që rrjedhin nga nenet 118 dhe 119, të Ligjit 52/2014, janë përfshirë në rregulloren nr. 85/1, datë 30.09.2015 "Për kriteret e risigurimit", e ndryshuar,	<a href="http://amf.gov.al/readLa.e.asp?id=10223">http://amf.gov.al/readLa.e.asp?id=10223</a>
3	Në lidhje me rregullat vendosen për	Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2016	Konsiderohet i paaplikueshëm	Për zbatueshmërinë e rekomandimit (3) Grupi do të konsiderojë informacionin e

<p><i>investimet e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike. Autoriteti duhet të bëjë një vlerësim të saktë të objektivit të sigurisë dhe likuiditetit në përcaktimin e limiteve të investimeve të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike në përputhje dhe me Direktivën 92/49/EEC, si dhe shkallën e zhvillimit të tregut financiar të brendshëm.</i></p>	<p>janë në linjë me direktivat (Council Directive 92/49/EEC of 18 June 1992 on the coordination of laws, regulations and administrative provisions relating to direct insurance other than life assurance and amending Directives 73/239/EEC and 88/357/EEC (third non-life insurance Directive)). Pra, përsa i përket kriterit minimal të riskut të kreditit për aktivet në mbulim të provigjoneve, nuk ekziston asnjë standard i tillë i unifikuar, përveç kriterëve që sugjerohen në direktivën e mësipërme. Ligji nr. 52, datë 22.05.2014 në pikën 2 të nenit 97, ndërmjet të tjerash thekson se: “shoqëria e sigurimit në zgjedhjen e llojit të investimeve të aktiveve në mbulim të PT, duhet të garantojë sigurinë, kthimin, likuiditetin dhe tregtueshmërinë e investimeve”. Në këto kushte, aktivet e parashikuara nga ligji si jolikuide në llogaritjen e kapitalit, janë konsideruar të papërshtatshme edhe për</p>	<p>dhënë nga AMF në plotësim të rekomandimit (2)(c), pasi mendon se si rekomandimi 3 ashtu dhe kërkesat e nenit 98 “Mbi përputhjen e investimeve të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike”, synojnë të njëjtin objektiv (vlerësim të saktë të sigurisë dhe likuiditetit të investimit). Për më tepër, kemi dhënë informacion të vecantë me e-mail.</p>
--	--	--

	<p>mbulimin e Provigjoneve Teknike. Gjithashtu Rregullorja nr. 19, datë 28.04.2015 "Për aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe llojet e investimeve të lejuara të këtyre aktiveve" u draftua në përqsje me direktivat e BE-së mbi kufizimet në lidhje me investimin e Aktiveve në Mbulim te Provigjoneve Teknike si edhe me praktikat më të mira marrë nga legjislacione të vëndeve si Itali, Kroaci dhe Bullgari lidhur me kufizimet e parashikuara në këtë rregullorë.</p>			
4	<p><i>Për të garantuar më tregje transparente si dhe përgjegjshmëri më të lartë nga ana e shoqërive, Autoriteti:</i></p>	<p>Në vijimësi</p>	<p>Po zbatohet në vijimësi</p>	

<p>a) <i>duhet të kërkojë nga shoqëritë të bëjnë publike treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe të likuiditetit sipas kritereve të vendosura nga kuadri rregullator.</i></p>	<p>Përsa i përket publikimit të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe likuiditetit, sipas Rregullores nr. 110 datë 26.10.2015, “Për përmbajtjen e raportit vjetor që publikohet nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit” nuk kërkohet specifikisht nga shoqëritë e sigurimit të publikojnë treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe të likuiditetit, si rrjedhim deri në 31.12.2016 do të propozohet amendimi i kësaj rregulloreje duke shtuar edhe këto kërkesa</p>	<p>Ne konsiderojmë qëndrimin e AMF për amendim të rregullores deri më 31.12.2016</p>
--	--	--

	<p><i>b) në raportet vjetore mbikëqyrjes të publikojë treguesit e aftësisë paguese dhe testet IRIS në nivel shoqërie.</i></p>	<p>Nuk gjenden eksperiencia të publikimit nga Autoriteti të treguesit të aftësisë për çdo shoqëri, por kjo është pjesë e publikimit që çdo shoqëri bën në uebsitin e saj. Ndërsa Autoriteti publikon treguesin e aftësisë paguese dhe treguesit e tjerë në nivel tregu.</p>	<p>Në raportin vjetor 2015 të AMF, ne gjejmë treguesit financiarë në nivel tregu. Për këtë arsye auditimi u krye për nivel shoqërie dhe rekomandimi synonte rrirjen e llogaridhënies dhe transparencës të AMF me publikun Megjithatë, ne konsiderojmë dhe vlerësojmë dhe praktikrat e institucioneve të tilla homologe në Europë dhe rajon, që në praktikrat e tyre nuk publikojnë të dhëna të tilla në nivel shoqërie. Referuar Raportit Vjetor 2015 të AMF-së, raporti i aftësisë paguese për tregun ishte 180.78% (intervali i pranuar 150-300), me tendencë rënie krahasuar me vitet parardhëse, ndërsa raporti dëme-prime ishte 38.75 (50-80).</p>
<p>5</p>	<p><i>Autoriteti duhet të vlerësojë, vendosë dhe të respektojë afatet për gatitjen dhe prezantimin e raporteve të analizave financiare nga strukturat mbikëqyrëse, duke synuar rrirjen e</i></p>	<p>Rekomandimi është zbatuar, me efekt për vitet në vijim</p>	<p>Vlerësojmë masat e marra nga AMF, për rishikimin e afatit të raportimeve financiare vjetore nga ana e shoqërive të sigurimeve.</p>
<p>Me synimin për plotësimin e këtij rekomandimi është rishikuar rregullojta nr. 34, datë 28.05.2015 “Për raportimin e detyruar dhe periodik të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 77, datë 30.05.2016, duke ndryshuar afatin e raportimit në AMF In-REGdhe</p>			

*efektivitetit të këtij funksioni.*

depozitimit në AMF të pasqyrave financiare të paaudituarra dhe raporteve statistikore (neni 4) nga data 31 Mars i vitit pasardhës në 31 Janar të vitit pasardhës, në mënyrë që procesi i analizave financiare të fillojë më herët dhe si rrjedhim edhe propozimet për marrjen e masave, në rast të mos raportimit në kohë dhe sipas kërkesave të kuadrit ligjor dhe rregullator. Duke marrë në konsideratë sa më sipër me qëllim rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes, Autoriteti do të angazhohet për përfundimin e raporteve të analizave financiare për vitin 2016 dhe në vijim në një afat më të shkurtër se praktika e deritanishme, kjo kushëzuar edhe nga afatet ligjore për depozitimin e pasqyrave të audituara të shoqërive të sigurimit.



6	<p>Në zbatim të nenit 85, pika h, Autoriteti të kërkojë nga shoqëritë e sigurimit të llogarisin dhe raportojnë raportet e likuiditetit në përputhje me standardet e fushës dhe/ose metodat që miraton vetë Autoriteti.</p>	<p><i>Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2016</i></p>	<p>Rekomandimi është zbatuar</p>	<p>Aktualisht është miratuar Rregullorja nr. 56, datë 28.04.2016 "Mbi administrimin e likuiditetit nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit".</p>	<p>Sipas kësaj rregulloreje përcaktohet: a) Metoda e llogaritjes së normës së likuiditetit; b) Plani i masave të përshatshme për parandalimin dheeliminimin e shkaqeve të mungesës së likuiditetit; c) Përmbajtja, mënyra dhe afatet kohore për njoftimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.</p>
7	<p>Autoriteti duhet të kërkojë nga shoqëritë e sigurimit jo jetë që, përveç provigjoneve të raportuara deri më sot, të llogarisin dhe raportojnë dhe provigjonet e tjera që parashikon neni 89 i ligjit 52/2014. Këto provigjone dhe metodologjia që shoqëria përdor për llogaritjen e tyre duhet të miratohet nga Autoriteti.</p>	<p><i>Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2016</i></p>	<p>Rekomandimi është zbatuar.</p>	<p>Në rregulloren nr. 9, datë 25.01.2016 "Mbi bazat dhe metodat e llogaritjes, mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike, si dhe kriteret dhe procedurat e miratimit të tyre nga Autoriteti", janë parashikuar edhe përcaktimet e provigjionit të bazimit të dëmeve dhe rezerva e katastrofës. Kjo rregullore është një rregullore e re, e cila ka dalë në zbatim të nenit 89 të Ligjit Nr. 52/2014, por në përmbajtje konsiston në rishikim të një rregulloreje ekzistuese që ishte miratuar në zbatim të ligjit Nr. 9267, datë 29.7.2004.</p>	<p>Deri në momentin e nxjerrjeve të akteve rregullative për metodologjitë e llogaritjes së rezervës së katastrofës, shoqëritë e sigurimeve mund të mos llogarisin dhe raportojnë këto rezerva. Por grupi vlerëson përfshirjen dhe asistencën e BB në këtë proces dhe respekton afatet e shtyra.</p>

Gjithashtu, me zhvillimin e kuadrit ligjor të tregut të sigurimeve, Autoriteti në bashkëpunim me ekspertë të Bankës Botërore në kuadrin e projektit "Shqipëria: Reforma e tregut të sigurimeve", i cili është zgjatur deri më 31 Mars 2017, po punojnë për hartimin e një rregulloreje të vecantë në lidhje me Rezervën e Katastrofës.

Lidhur me provigjionin e barazimit të dëmeve, theksojmë se provigjioni i barazimit të dëmeve, referuar ligjit (neni 89), praktikave me të mira, literaturës së fushës si dhe rregulloreve të vendeve të tjera, mbahet kryesisht për klasën 14, Sigurimi i Kreditit. Aktualisht asnjë nga shoqëritë e sigurimit të licencuara për klasën 14 (Sigurimi i kreditit) nuk paraqesin aktivitet në këtë portofol.

<p>8</p> <p><i>Autoriteti të ushtrrojë gjithë kompetencat ligjore për të kërkuar nga shoqëritë të raportojnë saktë dhe në kohë të gjithë informacionin financiar dhe teknik konform kuadrin rregullator dhe të depozitojnë raportet vjetore të audituara brenda afateve të parashikuara.</i></p>	<p><i>Në vijimësi</i></p>	<p>Rekomandimi është zbatuar.</p>	<p>Gjatë vitit 2015, AMF ka marrë 3 vendime, për marrjen e masave të mbikëqyrjes “Urdhër për eliminimin e shkeljeve”, që lidhet me detyrimin për raportim të saktë dhe në kohë, konform kërkesave të Ligjit 52/2014</p>	<p>Rekomandimi duhet të jetë në vëmendjen e institucionit në vijimësi. Këto vendime nuk bëhen publikë, që të na mundësojë kopjimin e linkut nga ëeb i AMF</p>
<p>9</p> <p><i>Për të rritur besueshmërinë në saktësinë e raportimeve, gjejet e konstatuara gjatë verifikimeve duhet të përshkruhen qartë dhe të shoqërohen me efektet financiare në rezultatet e periudhave analizohen.</i></p>	<p><i>Në vijimësi</i></p>	<p>Rekomandimi është zbatuar</p>	<p>Lidhur me efektin e gjetjeve të evidentuara nga inspektimet, Autoriteti në raportet e inspektimit ka vlerësuar si shumë të rëndësishëm evidentimin e fenomeneve (si p.sh nënprovionimin e dëmeve) dhe ndjekjen e tyre në vazhdimësi nëpërmjet monitorimit off site të tyre, me qëllim mospërsëritjen e tyre në të ardhmen. Në raportet e inspektimit, sistematikisht është dhënë në mënyrë të detajuar efekti që secila nga shkeljet e evidentuara ka mbi zërat e shqyrtuara. Konkretisht</p>	<p>Vlerësojmë sqarimet dhe gadishmërinë për informacion shtesë të stafit të AMF-së në lidhje me këtë çështje. Rekomandimi ynë kërkon vëmendjen e institucionit në vijimësi dhe për shkat të natyrës së tij, vlerësimi ynë për zbatimin e tij mbetet subjektiv.</p>

	<p>lidhur me nënprovigionimin e dëmeve, për rastet e konstatuara janë marrë masa: për përfshirjen e vlerës së nënprovigionuar në raportimin e ardhshëm financiar, është kërkuar ridepozitim i pasqyrave në rastet kur procesi i analizave ka qenë në proces në mënyrë që të pasqyrohej efekti në kohë; është aplikuar raporti i nënprovigionimit të konstatuar në kampionin e shqyrtuar për të gjithë totalin e provigionit të dëmeve të shoqërisë; etj.</p>		
--	--	--	--

10	<p><i>Autoriteti të shtojë kapacitetet mbikëqyrëse për tregun e sigurimeve mbështetur strukturës miratuar.</i></p>	<p><i>Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2016</i></p>	<p>Rekomandimi është zbatuar</p>	<p>Në zbatim të Vendimit të Bordit nr. 27, datë 28.04.2015, "për miratimin e strukturës organizative, numrin e punonjësve dhe përshkrimet e punës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar me Vendim nr. 78, datë 31.08.2015, është shtuar numri i të punësuarve në Departamentin e Mbikëqyrjes Financiare, në nivele larta drejtuese dhe nivel specialistësh. Janë emëruar: Drejtori i Departamentit të Mbikëqyrjes; Drejtori i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve; 4 specialistë në Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve. Aktualisht në qershor 2016, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve ka gjithsej 9 punonjës, ndërsa Departamenti i Mbikëqyrjes 17 punonjës.</p>
----	--	--	----------------------------------	---

11	<p><i>Autoriteti të konsiderojë si prioritare në planet afat-shkurtra, vlerësimin e profilit të rrezikut për çdo shoqëri nëpërmjet kryerjes së ciklit të mbikëqyrjes me bazë rreziku në të gjitha shoqëritë e sigurimeve jo-jetë.</i></p>	<p><i>Brenda vitit 2016</i></p>	<p>Rekomandimi është zbatuar</p>	<p>Pjesë e ciklit të plotë të mbikëqyrjes me bazë rreziku janë dhe kërkesat e Rregullores së miratuar me vendimin e Bordit nr. 18, datë 28.04.2015 “Për Rregullat e organizimit të sistemit të administrimit të rrezikut në shoqërinë e sigurimit”, ku për herë të parë i kërkohet shoqërive të sigurimit të ndërtojnë një sistem efektiv për administrimin e rrezikut, bazuar në natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarisë që ushtrojnë. Shoqëritë e sigurimit, kanë raportuar në AMF planin e testimit të vetëvlerësimit sipas kërkesave të rregullores në fjalë dhe AMF është në proces të vlerësimit të tyre.</p>	<p>Vlerëson masat e marra nga AMF. Është një proces i gjatë dhe kërkon angazhim serioz jo vetëm të stafit të AMF por dhe shoqërive të sigurimit. Ende nuk ka mbaruar afati i lenë nga grupi i auditimit të performancës.</p>
----	---	---------------------------------	----------------------------------	---	--

Për vitin 2016, brenda muajit Qershor ka përfunduar inspektimi i plotë me fokus riskun për një shoqëri sigurimi jo-jetë, ndërsa për 6 mujorin e dytë të vitit 2016, janë planifikuar të kryhen edhe 2 inspektime të plota me fokus riskun për dy shoqëri sigurimi jo-jete, dhe në varësi të vlerësimit të rreziqeve të çdo shoqërie sigurimi, do të kryhen edhe 3 inspektime tematike në shoqëri sigurimi jo-jetë.

<p>a) Në rastet e rënies së treguesve të aftësisë paguese nën nivelet e kërkuara, Autoriteti konform koadrit ligjor të marrë masa për raportime të shpeshta, me afate më të shkurtra se tremujore. Ndjekja dhe zbatimi i këtyre masave duhet të ndiqet me prioritet nga strukturat mbikëqyrëse dhe të zbatueshmërisë.</p>	<p>Në vijimësi</p>	<p>Rekomandimi është zbatuar</p>	<p>Grupi vlerëson masat e marra nga AMF në përmirësim të aftësisë paguese. Ky është një rekomandim që duhet të jetë në vëmendjen e autoritetit në vijimësi. Nisur nga qëllimi i rekomandimit, masat mbikëqyrëse kanë afate zbatimi të pëcaktuar në vendimet e Bordit dhe i japin efektet në periudhat në vijim. Nisur nga sa më sipër, ne konfirmojmë informacionin mbi masat e marra nga AMF pas përfundimit të auditimit. (këto vendime nuk bëhen publike sic shprehemi dhe në rekomandimin 14)</p>
<p>Autoriteti ka në vëmendje parashikimet ligjore përsa i përket masave që lidhen me treguesit financiarë të shoqërive të sigurimit. Masat i referohen rrethanave për marrjen e masave të mbikëqyrjes referuar nenit 150, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014. Masat e mbikëqyrjes propozohen sipas parashikimeve ligjore duke pasur si synim kthimin e shoqërisë në gjendje të shëndoshë për një afat kohor të caktuar (aftashkurtër në rastin e planit të masave dhe aflagjatë në rastin e rimëkembjes financiare). Këto masa kanë si qëllim korrigjimin apo ndërprerjen e rrethanave që vlerësohet objekt i masave të mbikëqyrjes. Masat e mbikëqyrjes paraqiten si për rastet e shkeljeve të rënda të rregullave të administrimit të rrezikut ashtu dhe për rastet kur Autoriteti e vlerëson se shoqëria e sigurimit/personi përgjegjës po kryen një veprim që mund të dëmtojë interesat e të siguruarve.</p>			



b) *Autoriteti, konform kuadrit ligjor, duhet të ndërtojë dhe t'i kërkojë shoqërisë së sigurimit skema masash në përputhje me kërkesat që vendosin direktivat e BE-së, në rastet e rënies së treguesve të aftësisë paguese nën nivelet e kërkuara.*

Gjatë vitit 2015, pas shqyrtimit të gjëndjes financiare të vitit 2014 dhe 3-mujorit të parë të vitit 2015, lidhur me rënien e treguesit të aftësisë paguese nën nivelin e kërkuar, janë marrë 4 vendime Bordin, përkatësisht 2 vendime për marrje masash korrigjuese, 1 vendim për plan biznesi dhe 1 urdhër për rritje kapitali dhe 1 vendim për plan rimëkëmbjeje financiare. Për periudhën 30.06.2015 deri më 30.09.2015, për 3 shoqëri sigurimi, të cilat kanë qenë me tregues të aftësisë paguese nën nivelin e kërkuar ju janë dërguar shkresa për marrje masash për përmirësimin e treguesve. Masat e Autoritetit që lidhen me treguesit e aftësisë paguese do të reflektohen në analizën e gjëndjes financiare të shoqërive për periudhat e raportimit në vijim.

13	<p><i>Në respektim të përcaktimeve ligjore, Autoriteti duhet të gjykojë dhe vlerësojë efektivitetin e përdorimit të masave administrative në formën e sanksioneve</i></p>	<p><i>Në vijimësi</i></p>	<p>Rekomandimi është zbatuar</p>	<p>Sipas argumentimit në rekomandimin 12, masat që lidhen me treguesit financiarë të shoqërive, kanë patur si qëllim korrigjimin e situatave përkatëse dhe nuk kanë qenë të orientuara drejt sanksioneve me gjorbë, masë e cila nuk do të përmirësonte në asnjë rast treguesit financiarë të shoqërisë. Bordi i Autoritetit me Vendimet nr. 12 dhe 13, datë 25.01.2016, ka dhënë dy masa administrative me sanksion me gjorbë ndaj drejtuesve të dy shoqërive të sigurimit në përputhje me pikën 4 të nenit 52 të ligjit 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar.</p>	<p><a href="http://amf.gov.al/pdf/publikime/1490_Nr.%2012,%20dat%C3%A4B%2025.01.2016.pdf">http://amf.gov.al/pdf/publikime/1490_Nr.%2012,%20dat%C3%A4B%2025.01.2016.pdf</a>  <a href="http://amf.gov.al/pdf/publikime/1491_Nr.%2013,%20dat%C3%A4B%2025.01.2016.pdf">http://amf.gov.al/pdf/publikime/1491_Nr.%2013,%20dat%C3%A4B%2025.01.2016.pdf</a></p>
14	<p><i>Në transparencë me publikun, Autoriteti të bëjë publike përmbajtjen e plotë të Vendimeve të Bordit për masat e marra.</i></p>	<p><i>Menjëherë</i></p>	<p>Konsiderohet pjesërisht aplikueshëm</p>	<p>Për të rritur llogaridhënien dhe transparencën me publikun grupi rekomandoi për AMF bëritjen publike të vendimit të bordit (në web nuk publikohet përmbajtja e masës, sic e tregon dhe linku <a href="http://amf.gov.al/pdf/publikime/1603_Nr.%20117,%20dat%C3%A4B%2019.07.2016.pdf">http://amf.gov.al/pdf/publikime/1603_Nr.%20117,%20dat%C3%A4B%2019.07.2016.pdf</a>). AMF gjatë hartimit të raportit ka observuar se... <i>publikimi i</i></p>	<p><a href="http://amf.gov.al/pdf/publikime/1490_Nr.%2012,%20dat%C3%A4B%2025.01.2016.pdf">http://amf.gov.al/pdf/publikime/1490_Nr.%2012,%20dat%C3%A4B%2025.01.2016.pdf</a>  <a href="http://amf.gov.al/pdf/publikime/1491_Nr.%2013,%20dat%C3%A4B%2025.01.2016.pdf">http://amf.gov.al/pdf/publikime/1491_Nr.%2013,%20dat%C3%A4B%2025.01.2016.pdf</a></p>

	<p>të zbatojnë një qasje të balancuar të bazuar në shembujt e vendeve të tjera. Në lidhje me këtë konstatim është konsultuar dhe me autoritetet rregullatore të disa vendeve si dhe në takimet e bëra me autoritetet e Austrisë, Sllovenisë, Maqedonisë, ku është konkluduar se edhe nga Autoritetet rregullatore homologe ndiqet e njëjta praktikë me argumentin e cituar më lart. Gjithashtu, lidhur me publikimin e vendimeve të Bordit të Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në mbledhjen e Bordit të AMF-së të datës 30.05.2016, është miratuar Rregullorja nr. 75, "Për komunikimin me median e publikun, publikimet dhe funksionimin e faqes së internetit", ku parashikohet se në mbledhjet e tij, Bordi duhet të përcaktojë vendimet që klasifikohen</p>	<p><i>përmbajtjes së tyre, e cila përmban si treguesit e shoqërisë ashtu dhe masat që duhet të marrë, do të cenonte interesat tregtare të subjektit.</i> Komenti i subjektit nuk shoqërohej me referenca ligjore përkatëse, dhe grupi duke i konsideruar treguesit e aftësisë paguese si treguesit më të rëndësishëm të shëndetit financiar të siguruesve mbeti në të njëjtin rekomandim. Grupi vlerëson masat e marra nga AMF në zbatim të këtij rekomandimi, me miratimin e rregullores nr. 75, datë 30.05.2016 "Për komunikimin me median e publikun, publikimet dhe funksionimin e faqes së internetit". Gjithashtu konsideron interpretimin e direktivës se transparencës dhe praktikave të sjella nga autoritetet e disa vendeve të BE dhe rajonit për mospublikim të masës, shprehur dhe në shënimin (B) të Bankës Botërore.</p>
--	---	---